

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-151/13

**Prishtinë,
8 Prill 2015**

Në çështjen juridike të:

Z M
P J S rruga.nr.3/3
N

Praraqitësi i kërkesës/Pala Ankuese

kundër

Q H
U 96
20... P

Pala përgjegjëse në kërkesë /Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtar, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin 06391), i datës 5 shtator 2012 , pas shqyrtimit të mbajtur me 8 Prill 2015, morri këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z M kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 të datës 5 shtator 2012 lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA06391.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 i datës 5 shtator 2012, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA06391.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 1 dhjetor 2007, Z R M (në tekstin e mëtejshëm : paraqitësja e kërkesës), duke vepruar në emër të babait të saj të ndjerë, D H R , ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP),duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr. 586 -livadh me sipërfaqe 00.22.76 ha, që ndodhet në zonën kadastrale, Dushanovë, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm : prona e kërkuar).
2. Paraqitësja e kërkesës thekson se babai i saj i ndjerë ka qenë bashkëpronar i pronës së kërkuar. Të drejtën pronësore nuk mund ta ushtrojë për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, ku përmend datën 15 qershor 1999, si datën e humbjes. Më tej, paraqitësja e kërkesës deklaron se prona e kërkuar shfrytëzohet nga persona të panjohur me të cilët ajo nuk ka mundur të bie në kontakt dhe se sipas informacioneve të saj në pronë janë ndërtuar objekte.
3. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKP ndër të tjera :
 - Certifikatën e Lindjes Nr. 1269/18 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil , Komuna e Prizrenit me datën 1 Mars 1996 me të cilën dëshmohet lidhja familjare mes saj dhe babait të saj.
 - Aktvendimin e Trashëgimisë T.Nr.195/97 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prizrenit me datën 4 gusht 1998 sipas të cilit , D R trashëgon 1/3 pjesë ideale të pronës së kërkuar nga babi i tij i ndjerë, H R .

- Kopjen e Planit nr. 953-2/2002-485 të lëshuar nga Instituti Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër të Pronës së Paluajtshme në Prizren me datë 25 tetor 2002. Sipas kopjes së planit prona a kërkuar, ngastra nr. 586 me kulturë livadh dhe sipërfaqe 00.22.76 ha e cila gjendet në zonën Kadastrale Dushanovë , në Komunën e Prizrenit figuron në emër të H R R .
 - Fletën Poseduese nr. 72 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi e Komunës së Prizrenit me datë 4 dhjetor 2006. Sipas fletës poseduese prona e kërkuar, ngastra 586 është e ndarë në dy pjesë , ngastra 586/2 me kulturë livadh dhe me sipërfaqe 00.18.76 ha gjendet në emër të tre bashkëpronarëve (D , M dhe T R).
 - Deklaratën me shkrim Nr.1825 të çertifikuar në Administratën për çështje Civile në Komunën e Nis-it përmes së cilës tre dëshmitarë deklarojnë se D dhe D R është i njëjti person.
4. Më 8 shtator 2008, AKP-ja ka bërë identifikim e pronës duke e vendosur një shenjë në vendin ku ndodhej ngastra. Në pronën e kërkuar ishte një objekt që shfrytëzohej si lokal dhe ishte në posedim të Q H (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në kërkesë). Identifikimi i pronës ishte kontrolluar sërish në mars të vitit 2010, bazuar në koordinatat e GPS-it dhe ortofotos u konstatua se identifikimi i pronës ishte i saktë.
 5. Më 16 shtator 2008, pala përgjegjëse në kërkesë merr pjesë në procedurën para AKP-së, duke mohuar pretendimet e paraqitësit të kërkesës dhe duke kërkuar interes ligjor për pronën që është objekt i kërkesës.
 6. Për të mbështetur pretendimin e tij ai ka dorëzuar në AKP mes tjerash këto dëshmi :
 - Kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë të lidhur mes Qazim Nivokazit si shitës i paluajtshmërisë dhe M H si blerës me datën 17 shkurt 1979 . Kontrata nuk është e legalizuar dhe ngastra si objekt i shitjes nuk është e specifikuar.
 - Kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë , Leg.Nr.2866/81 e lidhur me datën 24 dhjetor 1981 mes shitësit të paluajtshërisë, H R dhe blerësit M H . Objekt i shitblerjes ishte prona e kërkuar, ngastra 586 me sipërfaqe 00.05.00 ha.
 - Aktvendim Nr.04/1-313-423 i lëshuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, Sekretariati për ekonomi me datën 26 nëntor 1981 në bazë të cilës, M H i lejohet themelimi i dyqanit zejtar.
 - Kërkesë Padi P. Nr. 388/82-IV për dorëzim paluajtshmërie , drejtuar Gjykatës Komonale në Prizren me datën 9 nëntor 1982 , nga paditësi H R ndaj të paditurve (K G , R K , E G , Xh K) ndër tjerë është edhe M H .
 - Aktgjykim C. Nr. 388/82 të lëshuar nga Gjykata Komonale në Prizren me datën 9 dhjetor 1982 me anë të cilit aprovohet kërkesë padia e H R dhe vërtetohet se ai është pronarë i ngastër 586. Të paditurit obligohen ta pranojnë dhe paluajtshmërinë të ia dorëzojnë në

posedim të lirë ose të paguajnë kundërvlerën e pronës e cila do të vërtetohet me procedurë të veçantë. Vërtetohet se pala paditëse e ka tërhequr padinë ndaj të paditurit M H .

- Aktvendim, Ac.nr. 290/83 të lëshuar nga Gjykata e qarkut në Prizren me datën 10 mars 1983. Sipas aktvendimit prishet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren K.Nr.388/82 i datës 9 dhjetor 1982 dhe atë në pjesën e gjykuar të kërkesës së padisë lidhur me vendimin mbi shpenzimet procedurale dhe për këtë pjesë lënda kthehet në rishqyrtim. I njëjti aktgjykim mbetet i paprekur sa i përket pjesës ku padia ndaj të paditurit M H , është tërhequr.
 - Deklaratë me shkrim e datës 15 shtator 2009. Pala përgjegjëse në kërkesë deklaron se prona e kërkuar është blerë nga babai i tij i ndjerë, M H qysh në vitin 1979 nga Q N dhe qysh në vitin 1979 është ndërtuar objekti në të cilën i ndjeri M H e ka ushtruar zejen e gateristit (sharagjisë). Në vitin 1981, M H u detyrua që sërish ta blejë ngastrën 586 nga H R i cili në bazë të dokumentacionit ishte pronarë. Kontrata mbi shitblerjen e pronës (Leg.nr.2866/81) u vërtetua në Gjykatën Komunale të Prizrenit me datën 24 dhjetor 1981 dhe që nga atëherë, i ndjeri M H e ka shfrytëzuar pronën pa asnjë pengesë. Ish pronari i pronës së kërkuar, H R në vitin 1982 kishte paditur disa individë, ndër ta edhe të ndjerin M H mirëpo më vonë e kishte tërhequr padinë ndaj M H , fakt ky që mund të vërtetohet me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.Nr.388/82 të datës 9 dhjetor 1982. Pala përgjegjëse në kërkesë propozon që kërkesa të hedhet poshtë si e pabazuar.
7. Sipas raporteve të verifikimit të AKP-së të vitit 2012, Aktvendimi, Ac.nr. 290/83 i lëshuar nga Gjykata e qarkut në Prizren me datën 10 mars 1983 dhe Aktvendimi Nr.04/1-313-423 i lëshuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit janë verifikuar pozitivisht. Sa i përket pronës së kërkuar, ngastra 586 është gjetur e ndarë ku ngastra nr. 586/1 figuron në emër të M M ndërsa ngastra nr. 586/2 figuron në emër të tre bashkëpronarëve (D , M dhe T R). Azhurnimi në vitin 2005 ka të bëjë me përmirësimin e emrit të njërit nga bashkëpronarët dhe atë nga D R që ka qenë gabim teknik në D R .
8. Më 5 shtator 2012 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj KPCC/D/A/164/2012 ka refuzuar kërkesën. Në paragrafin 94-97 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 5 shtator 2012, zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, theksohet se paraqitësja e kërkesës kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore ndaj pronës së kërkuar dhe në mbështetje të kërkesës të saj ka dorëzuar mes tjerash aktvendimi trashëgimie të vitit 1998 përmes të cilit babi i saj ka trashëguar pronën e kërkuar. Megjithatë, pala përgjegjëse në kërkesë pretendon se babai i tij i ndjerë e ka blerë pronën e kërkuar nga gjyshi i paraqitëses së kërkesës dhe në mbështetje të pretendimi të tij ka paraqitur kontratë blerje të vërtetuar në gjykatë në vitin 1981. Paraqitësja e kërkesës mohon shitjen megjithatë nuk i ka mbështetur pretendimet e saj. Bazuar në dëshmitë para

tij, Komisioni arrin në përfundim se prona e kërkuar ishte shitur para konfliktit dhe për rrjedhojë, paraqitësja e kërkesës ka dështuar të demonstrojë të drejtën pronësore ose të drejta tjera pronësore për pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-1999. Rjedhimisht kërkesa refuzohet.

9. Më 19 prill 2013, vendimi i është dorëzuar Zorica Misić-it dhe ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me datën 17 maj 2013 (në tekstin e mëtejshëm: Pala ankuese). Pala përgjegjëse në kërkesë ka pranuar vendimin me datën 23 prill 2013 në cilësinë e palës përgjegjëse.

Pretendimet e palës ankuese

10. Zorica Misić pretendon se KKPK ka konstatuar faktet në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë dhe ka bërë aplikimin e gabuar të drejtës materiale dhe procedurale.
11. Sipas Palës Ankuese, gjyshi i saj i ndjerë, H R ishte pronarë i pronës së kërkuar dhe pas vdekjes së tij, në vitin 1998 pas përfundimit të procedurës trashëgimorë në Gjykatën Komunale në Prizren si trashëgimtarë u shpallë babai i saj bashkë me vëllezërit e tij. Sipas arsytimit të vendimit të KKPK-së, Q H pretendon se babai i tij M H e ka blerë pronën e kërkuar nga H R gjatë vitit 1981 dhe si provë ka paraqitur kontratën e blerjes. Pala ankuese thekson se kontratën në fjalë nuk e ka parë asnjëherë dhe nuk është e informuar se kjo kontratë ekziston për më tepër dyshon në vërtetësinë e kontratës së blerjes pasi që gjyshit i saj, H R gjatë procedurave gjyqësore pranë Gjykatës themelore në Prizren, Gjykatës së Qarkut në Prizren si dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në vitet 1985 -1986 iu është njohur e drejta pronësore ndaj parcelës 586.
12. Pala Ankuese propozon që Gjykata Supreme ta anuloj në tërësi vendimin e atakuar dhe ta miratojë kërkesën e saj si dhe të konfirmojë të drejtën pronësore në emër të babait të saj.
13. Pala ankuese, si provë shtesë në mbështetje të ankesës ka paraqitur:
 - Aktgjykimin Ac.nr.515/85 të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës me datën 7 janar 1986 sipas të cilës refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit (E G) dhe konfirmohet aktgjykimi C. Nr. 16/85 i datës 21 shkurt 1985. Me aktgjykimin e atakuar, të paditurit obligohen që paditësin (H R) ta kompensojnë me shumën totale 1.250.000 dinarë për uzurpimin e pronës, konkretisht ngastrës 586.
14. Pala përgjegjëse në ankesë e ka pranuar ankesën me datën 4 tetor 2013 kurse është përgjigjur në ankesë me datën 7 tetor 2013
15. Në përgjigjen e tij, ai përsëritë pretendimet e njëjta që i kishte bërë para KKPK-së duke theksuar faktin se gjyshi i palës ankuese kishte tërhequr padinë ndaj M H në momentin kur është përpiluar

dhe vërtetuar pranë gjykatës kompetente kontrata e blerjes gjithnjë duke iu referuar aktgjykimit C.Nr.388/82 të datës 9 dhjetor 1982.

Arsyetim ligjor:

16. Gjykata Supreme e Kosovës vendimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se:
17. Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor sipas Ligjit Nr. 03/L-079, ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.
18. Megjithatë, ankesa është e pabazuar.
19. Ndonëse objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet ankimore të palës ankuese se babai i saj ishte shpalluar trashigimtarë për pronën e kontestuar dhe se prona e kontestuar ishte regjistruar në librat kadastral në emrin e tij, Gjykata Supreme, nuk gjeti se këto pretendime ankimore janë të bazuara. Kjo ngase sipas kontratës për shitblerjen e pronës së paluajtshme të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.Nr.2866/81 me datën 24 dhjetor 1981, ngastën kadastrale nr.586 livadh të klasit të dytë me sipërfaqe 00.05.00 ha, gjyshi i palës ankuese, H R ia kishte shitur M H nga fshati Dushanovë. Kjo kontratë është juridikisht e vlefshme.
20. Poashtu me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. Nr. 388/82 të datës 9 dhjetor 1982 konstatohet se paditësi, H R e ka terheq padinë ndaj të paditurit M H. Ky aktgjykim është vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr. 290/83 me datën 10 mars 1983.
21. Po kështu, Gjykata Supreme i vlerësoi edhe pretendimet e palës ankuese në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr.515/85 të datës 7 janar 1986 dhe gjeti se me anë të këtij aktgjykimi është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr. 16/85 në bazë të cilit është vendosur që të paditurit (K G i, R Kryeziu, E G dhe Xh K) të ia paguajnë paditësit, H R, kompensimin e dëmit për ngastrën kadastrale që është objekt i kësaj kërkesë. Prandaj, pala ankuese ka pasur mundësi juridike që ta kërkojë ekzekutimin e këtij aktgjykimi.
22. Gjykata Supreme gjen se pala ankuese nuk ka arritur që me prova juridikisht të vlefshme të demostrojë të drejtën pronësore apo të drejta tjera që rrjedhin nga e drejta pronësore andaj edhe e vërtetoi vendimin e ankimuar si të drejtë, të plotë, të kuptueshëm dhe të ligjshëm.
23. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit 03/L-079, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këshillë ligjore:

24. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetarë i Kolegjit

Willem Brouwer , Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it